



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 437/12 dt. 09.07.2012

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7, pika 2.3 dhe pika 4, Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr.11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 09/2012), në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2012 ka marrë këtë:

V E N D I M

I. Akreditohet Universiteti në themelim "Haxhi Zeka" në Pejë në nivel institucional për periudhë 1 vjeçare (1 tetor 2012-30 shtator 2013) me kusht që brenda kësaj kohe të sqarohet statusi i tij ligjor.

II. Akreditohen programet e studimit:

- Administrim Biznesi (BA) (me specializime në Administrim Biznesi; Kontabilitet dhe Financa; Turizëm dhe Menaxhim i Hotelerisë);
- Administrim Biznesi (MA)
- Kontabilitet dhe Financa (MA)
- Juridik (LLB)
- Teknologji e prodhimtarisë bimore (BSc)
- Agro Ekologji dhe Agro Mjedis (BSc)

për periudhë 1 vjeçare (1 tetor 2012-30 shtator 2013) me mundësi të zgjatjes së akreditimit pas sqarimit të Statusit ligjor të UPe.

III. Programet e studimit:

- Edukimi i Përgjithshëm në Muzikë (BE dMuz)
- Edukim në Muzikë (BE dMuz)

akreditohen për periudhë 1 vjeçare (1 tetor 2012 – 30 shtator 2013).

IV. Programet e studimit:

- Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë (MSc)
- Menaxhim i Mjedisit (BA)
- Pikturë (BA)

Nuk akreditohen

IV. Institucioni i juaj është i obliguar qe të harton një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (ne te dy gjuhët dhe ne te dy versionet) dhe te njëjtin ta dorëzoni në AKA gjer më 1 Nëntor 2012.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.



F. Zhusi

Dr.sc. Ferdije Etemi-Zhushi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë